



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**PROJEKT - V E N D I M**

Nr.19, datë 20.06.2018

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“SHTESË KATESH DHE RIKONSTRUKSION FASADE PËR OBJEKTIN: “SKY**  
**TOWER”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN: “IBRAHIM RUGOVA”, BASHKIA**  
**TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Lani” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesë katesh dhe Rikonstruksion fasade për objektin: “Sky Tower”, me vendndodhje në Rrugën: “Ibrahim Rugova”, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Lani” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**E D I R A M A**

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA